



Pranuar / Dorezuar Punëdhënësi/Pradato Received/Delivered	11. 11. 2020	0	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPJESHKE	2553/2020		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.272/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.272/2020 të datës 16/09/2020 të parashtruar nga ankuesi ██████████, zyrtarë në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, kundër Vendimit me Nr. Prot:1304 të datës 28/07/2020 të Komisionit Disiplinor të Universitetin “Haxhi Zeka”Pejë, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.11.2020, mori këtë

V E N D I M

I.Obligohet Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Universitetit Haxhi Zeka të Pejës që të bëjë shqyrtimin e ankesës me numër protokoli 1444 të datës 26.08.2020, të paraqitur nga parashtruesi i ankesës ██████████, duke shqyrtuar hollësisht të gjitha pretendimet të cilat ndërlidhen më këtë ankesë, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

II.Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit Haxhi Zeka të Pejës ti ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që zbatimi i këtij vendimi të bëhet brenda afatit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.

III.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

IV.Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e kryetarit të kolegjit.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit ██████████ i punësuar në pozitën Drejtor i Prokurimit, në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, me datën 29.06.2020 është inicuar procedurë disiplinore lidhur me procedurën e prokurimit “Ndërtimi i Fakultetit të Arteve Faza e IV”. Komisioni Disiplinor me datën 28.07.2020 ka nxjerrë Vendimin me nr. 1304 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore “largim nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër brenda Universitetit “Haxhi Zeka”-Pejë, në të njëjtin hap dhe gradë, dhe të njëjtit i ndalohet gradimi deri në gjashtëdhjetë (60) muaj”.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me nr. 1304 të datës 28.07.2020 të Komisionit Disiplinor në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, me datën 26.08.2017 ka parashtruar ankesë me nr.1444 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë.

Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë me datën 14.09.2020 ka përcjellë ankesën e ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me arsyetimin se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë nuk është kompetent me vendos për ankesën e z. ██████████, bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06/L-144 për Zyrtarët Publik dhe nenit 16 të Rregullores nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik.

Me datën 16.09.2020 përmes postës ka ardhë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesa me numër protokolli 1777/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 22.09.2020 ka përcjell kërkesën për përgjigje në ankesë te punëdhënësi i ankuesit, Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka". Me datë 09.10.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Universiteti i Pejës, bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Më datë 27/11/2020 sipas kërkesës si kryesues i kolegjit, kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin VK.nr.8/2020 me që rast i është vazhduar afati i shqyrtimit të ankesës edhe për 10 ditë për arsye të kompleksitetit të natyrës së lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 16/09/2020 me numër protokolli 1777/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dosja e tenderit e përgatitur me datën 21.05.2020; Kërkesë për shtyrje të afatit dhe të hapjes se tenderit dhe afatit për sqarime në dosjen e tenderit e datës 21.05.2020; E-mail zyrtar i datës 21.05.2020; Njoftim lidhur me procesin e deri tanishëm i datës 29.06.2020; Kërkesë e datës 01.07.2020; Rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave; Ankesa e datës 18.07.2020 për procedurat e konkurrimit Ndërtimi i Fakultetit të Arteve (faza e katërt); Kërkesë për sqarime shtesë 01.07.2020; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 29.06.2020; E-mail zyrtar i datës 29.06.2020; Vendim i datës 22.06.2020 për aprovim; Vendim i datës 22.06.2020 për refuzim; Njoftim i datës 12.06.2020; E-mail i datës 21.05.2020; E-mail zyrtar i datës 22.06.2020; E-mail i datës 02.07.2020; Vendim i datës 15.05.2020; Njoftimi i datës 03.07.2020, Kërkesë e datës 01.07.2020, E-mail zyrtar i datës 01.07.2020, e-mail zyrtar për ██████████ i datës 03.07.2020, Mesazh përmes e-mailit zyrtar për Driton Fetaj i datës 03.07.2020 nga anëtarë i Komisionit Korab Çeku, Dokumentet për procesin e vlerësimit të tenderit me titull "Ndërtimi i Fakultetit të Arteve(Faza e katërt)", e-mail zyrtar i datës 04.06.2020, e-mail zyrtar i datës 08.06.2020, Kërkesë për sqarimin shtesë për procedurën e prokurimit me titull Vlerësimi i tenderit me titull "Ndërtimi i Fakultetit të Arteve (Faza e katërt)" Nr.i Prokurimit 208 20 013 151 i datës 17.06.2020, Letër standarde e datës 12.06.2020, sqarim shtesë, Ankesat për procedurën me titull dhe nr.prokurimi Ndërtimi i Fakultetit të Arteve(Faza e katërt), uhz -20-2062-5-1-1 i datës 18.06.2020 dhe 19.06.2020; Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 03.07.2020 i intervistuari Driton Fetaj, Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 03.07.2020 i intervistuari Luan Lulaj, Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 03.07.2020 i intervistuari Astrit Ademaj, Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 06.07.2020 i intervistuari Durim Hoxha, Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 06.07.2020 i intervistuari Veton Jahmurataj, Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 06.07.2020 i intervistuari Korab Çeku, Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 06.07.2020 i intervistuari Luan Lulaj, Procesverbal nga takimi i Komisionit Disiplinor me datën 06.07.2020 i intervistuari Përparim Blakaj, Procesverbal nga takimi i

Komisionit Disiplinor me datën 06.07.2020 i intervistuari Butrint Xhemajli, Vendimi me Nr.1\KD i datës 28.07.2020 i Komisionit Disiplinor të Universitetit "Haxhi Zeka", në Pejë, Njoftimi i datës 03.07.2020, Kërkesë e datës 01.07.2020, E-mail zyrtar i datës 01.07.2020, e-mail zyrtar për [REDAKTUAR] i datës 03.07.2020, Mesazh përmes e-mailit zyrtar për [REDAKTUAR] i datës 03.07.2020 nga anëtarë i Komisionit Korab Çeku, Dokumentet për procesin e vlerësimit të tenderit me titull "Ndërtimi i Fakultetit të Arteve Faza e katërt"; Ankesa e datës 18.07.2020 për procedurat e konkurrimit Ndërtimi i Fakultetit të Arteve (faza e katërt); Vendimin me Nr. Prot:1304 të datës 28/07/2020 të Komisionit Disiplinor të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë Ankesa me nr.1444 e datës 26.08.2020 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 09.10.2020 bashkë me shkresat e lëndës; E-mail i datës 05.11.2020 nga menaxherja e personelit me provat: Vërejtje me shkrim e datës 22.06.2020 dhe Vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit me nr.496-507-510/20 i datës 28.09.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar me kujdes të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Universitetit "Haxhi Zeka", ka mandat ligjor për trajtimin e kësaj lënde dhe kjo rrethanë ligjore mbështetet respektivishtë konfirmohet edhe nga vetë organi i punësimit mbi bazë të Vendimit me numër 1304 i datës 28.07.2020 i Komisionit Disiplinor në Universitetin "Haxhi Zeka"-Pejë i cili përkundër që është i pa vulosur dhe në këtë kohë ka qenë në fuqi ligji Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik në këshillën juridike e ka obliguar ankuesin që kundër këtij vendimi të parashtronte ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka".

Mbi bazë të asaj që u konstatue më lartë duke u mbështetë në legjislacionin që ka qenë në fuqi në momentin e krijimit të këtij kontesti është një rrethanë juridike tjetër me rëndësi vendimtare që prodhon efektin juridik respektivisht të drejtën e komisionit të ankesave të punëdhënësit në këtë rastë që të vendosë në lidhje me këtë kontestë administrativë sepse procedura disiplinore ka filluar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregullorja Nr.05/2011 për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Civil e që në këtë rastë krijojnë kompetencën ligjore të këtij organi të punësimit që të vendosë sa i përket ankesës së parashtruar nga ankuesi sipas kësaj lënde.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 83 paragrafi 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, vlerëson së procedurat disiplinore dhe procedurat e ankesave dhe kontesteve të cilat kanë filluar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do të vazhdojnë sipas dispozitave të atij ligji, përveç nëse vlerësohet nga pala se është më e favorshme procedura e ligjit të ri, por aplikimi i ligjit të ri mund të bëhet vetëm me kërkesë të palës e në këtë rastë nuk kemi ndonjë kërkesë të palës/ankuesit përmes së cilës formë kërkohet të aplikohen dispozitat e ligjit të ri Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, por përkundrazi pala me ankesën e datës 26/08/2020 i është drejtuar komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të punëdhënësit Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë. Pra fakti që ankuesi i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të punëdhënësit Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë është një bazë e mjaftueshme ligjore të nënkuptohet e drejta e palës në këtë rastë ankuesit që mbi bazën e ligjit të ri Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik neni 83 paragrafi 9, që është në fuqi në kohën e parashtrimin të ankesës nuk ka kërkuar që të zbatohen dispozitat e ligjit të ri nga se nuk konsideron se janë më të favorshme dispozitat aktuale të ligjit të zyrtarëve publik që është në fuqi sa i përket kësaj çështje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, mbi bazë të analizimit të provave që janë në shkresa të lëndës konstaton se procedura në lidhje me këtë çështje që është objektë i shqyrtimit të kësaj lënde ka filluar sipas dispozitave të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës, duke u bazuar në nenin 131 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës, nenin 83 paragrafi 9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, si dhe nenin

16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mori vendim që lënda ti dërgohet për vendosje Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të punëdhënësit në këtë rast për vendosje meritore të kësaj lënde dhe se është obligim ligjor i këtij organi që të veproj konformë dispozitivit të këtij vendimi

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit ██████████
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr.272/2020

Sabile Avdyli
Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

